



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Qershor 2022

6

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT MERR PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Për herë të parë, Shqipëria u përfaqësua nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët **në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)**, New York, SHBA, në debatin e nivelit të lartë me temë "Rritja e integritetit të të rinjve në politikën e parandalimit të krimit", më 6 qershor. Ky debat, i cili u zhvillua nga organizata më e lartë për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, kishte si qëllim **adresimin e rolit të të rinjve në politikën e parandalimit të krimit dhe promovimin e shtetit të së drejtës**.

Gjatë vizitës në New York, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë edhe në **festivalin e parë të shkollave shqipe "Alba Life" në mbyllje të vitit mësimor 2021-2022**. Si dhe **u takua me komunitetin shqiptar në New York**, të cilët promovojnë kulturën shqiptare anembanë botës.



KONSOLIDOHET MARRËVESHJA PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E RINISË MES SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe ajo e Kosovës **nënshkruan Marrëveshjen për Bashkëpunim në Fushën e Rinisë**, me qëllim mbështetjen e politikave dhe programeve të përbashkëta, si dhe të nismave rajonale dhe evropiane, në mbledhjen e tetë mes dy qeverive.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi është hartuar një plan konkret sa i përket **angazhimit të të rinjve në dy vendet respektive**, me qëllim **fuqizimin e tyre në vendimmarrjen qendrore dhe vendore**, nëpërmjet politikave më të mira për ta. Duke krijuar kështu **ura bashkëpunimi** edhe për aktivitete të përbashkëta që përfshijnë rritjen e mundësive për **shkëmbime rinore në fushën artistike, sportive dhe kulturore**, në kuadër të edukimit joformal. Element i rëndësishëm në këtë bashkëpunim do të jetë dhe **mbështetja në zhvillimin e karrierës dhe aftësive profesionale të të rinjve**.

MBAHET KONFERENCA KOMBËTARE "KËSHILLAT VENDOR RINOR - TË RINJTË NJË HAP MË PRANË VENDIMMARRJES"

Me qëllim **rritjen e bashkëpunimit mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore** për zbatimin e politikave rinore, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët bëri bashkë kryetarë dhe nënkryetarë të bashkive nga e gjithë Shqipëria, punonjës të sektorit të rinisë, organizatat ndërkombëtare dhe ato rinore, si dhe anëtarë të Këshillave Vendor Rinor (KVR) dhe Këshillit Kombëtar Rinor, **në konferencën kombëtare "Këshillat Vendor Rinor - Të rinjtë një hap më pranë vendimmarrjes"**.

Kjo konferencë kishte në themel të saj **promovimin dhe bashkëpunimin e mëtejshëm midis qeverisjes vendore dhe KVR-ve**, si dhe **partneritetin efektiv** për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e këtij organi këshillimor. Këshilli Vendor Rinor shërben si mekanizëm ndërlidhës ndërmjet bashkisë dhe komunitetit rinor, për të evidentuar problematikat dhe sfidat që hasen nga të rinjtë në territorin ku jetojnë, njëkohësisht edhe për rritjen e përfshirjes së tyre në politikëbërje. Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka ndërmarrë iniciativën për të **hartuar një udhëzues për fuqizimin e KVR-ve**, pas krijimit të manualit për ngritjen e Këshillave Vendor Rinor.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Qershor 2022

6

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



NËNSHKRUHEN MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRITË TREGTARE DHE SHOQATAT NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët **nënshkroi marrëveshjet e bashkëpunimit me shoqatën "Confindustria Albania" dhe bizneset e suksesshme që aderojnë në të**, për t'iu ofruar të rinjve shqiptarë më shumë mundësi për praktika pune në shoqëri tregtare, në kuadër të Thirrjes së shtatë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Gjatë këtij muaji u zhvilluan dhe takime me organizatat jofitimprurëse dhe shoqëri tregtare për përfshirjen e tyre si pjesë të programit. Përveçse një eksperiencë shumë e vlefshme për zhvillimin e aftësive profesionale, akademike dhe personale, praktika e punës iu vlen të rinjve pjesëmarrës edhe si përvojë e njohur pune në çdo aplikim të mëtejshëm. Target grupi i këtij programi janë të rinj profesionistë, mosha 21-26 vjeç, të cilët kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve "Bachelor".



INICIOHET "JUNIOR MINISTER" PËR 1 QERSHOR, NISMA NOVATORE QË SJELL FËMIJËT MË PRANË PUNËS SË NJË MINISTRI PËR NJË DITË

Në Ditën e Fëmijëve, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka ndërmarrë **nismën "Junior Minister"**, që kishte si qëllim t'iu ofronte fëmijëve të grup moshës 12-18 vjeç një **eksperiencë unike në koordinimin e institucionit** si dhe të afrojë fëmijët më shumë me punën e një ministri. **118 fëmijë nga shkolla dhe qytete të ndryshme** të Shqipërisë shprehën dëshirën për të qenë një ditë Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët, ku u përzgjedh njëri prej tyre. Përgjatë gjithë ditës së 1 qershorit, nxënësi i përzgjedhur e **ka shoqëruar ministren** në vizitën e zhvilluar në Institutin e Fëmijëve që nuk Shikojnë "Ramazan Kabashi", në panairin e punëve të fëmijëve, në takimin me ministren e Shtetit për Standardet e Shërbimeve, si dhe ka drejtuar një mbledhje kabineti. Pjesë e këtij shoqërimi ka qenë edhe Maria, 15-vjeçarja që ka zhvilluar më parë praktikën shkollore pranë këtij institucioni.



PREZANTOHET DRAFTI I UDHËRRËFYESIT PËR TRANZICIONIN E TË RINJVE NGA SHKOLLA NË VENDIN E PUNËS

Pas një viti të gjatë pune në bashkërendim të vazhdueshëm midis institucioneve qeveritare dhe organizatave rinore, më 11 qershor u prezantua **drafti i Udhërrëfyesit për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës**. Kjo pas shumë **takimeve konsultuese** të zhvilluar më parë me të rinjtë dhe përfaqësuesit e organizatave rinore/ për të rinjtë. Ky dokument, i pari në llojin e tij në Ballkan me fokus te punësimi, **analizon sfidat por edhe ofron rekomandime për tranzicionin e të rinjve nga shkolla në punë**. Rekomandimet janë përfshirë si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Nisma e Laboratorit Rinor të Ballkanit Perëndimor ka përfshirë institucionet publike si Ministria e Arsimit dhe Sportit edhe Agjencia Kombëtare e Rinisë si organ zbatues i politikave rinore dhe organizatat rinore si Kongresi Rinor Kombëtar (KRK), Rrjeti i Profesionistëve të Rinj dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri.



MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT MIRËPRET NË TIRANË PRESIDENTIN E KOMITETIT OLIMPIK NDERKOMBËTAR (IOC) THOMAS BACH

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Kryeministrin, Ministren e Arsimit dhe Sportit, dhe presidentin e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, mirëpriti në Tiranë, në vizitën e tij të parë, presidentin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC) Thomas Bach, më 12 qershor. **Kjo për të bashkëpunuar akoma më tepër në projekte që do të forcojnë lëvizjen olimpike në vendin tonë**. Gjatë kësaj dite u mbajt dhe ceremonia e inaugurimit të zyrave të reja të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të cilat janë shpërngulur në Parkun Olimpik, në një nga investimet me të mira për Sportin, pranë zyrave të Federatave Sportive të tjera. Gjithashtu u zhvillua dhe një **kampionat volejboli mes ekipit të vajzave dhe djemve**, si pjesë e Programit Kombëtar të Ekipave Sportive.



AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË ZHVILLON TRAJNIMIN "FILLO DUKE KODUAR"

Me synimin për të **ritur kapacitetet në fushën e kodimit dhe sipërmarrjes**, Agjencia Kombëtare e Rinisë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Junior Achievement Albania zhvilloi **trajnimin "Fillo Duke Koduar"**, duke i dhënë kështu një fokus të veçantë zhvillimit të digjitalizimit të të rinjtë. **50 të rinj të moshës 15-18 vjeç**, nga e gjithë Shqipëria, patën mundësinë të zgjerojnë horizontin e tyre në fushën e kodimit dhe sipërmarrjes përgjatë 3 ditëve të trajnimit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në këtë drejtim. Në fund të trajnimit, **3 idetë më të mira** u vlerësuan me **çmime simbolike dhe me bursa studimi për sipërmarrjen**.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi